



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

## E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 12-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 31. 10. 2018, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10<sup>00</sup>

### Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Anila Reçica, anëtare
7. Ramadush Tasholli, anëtar
8. Naim Jahiri, anëtar
9. Naim Stullca, anëtar
10. Majlinda Sylejmani, anëtare
11. Lulzim Rrustemi, anëtar
12. Ramiz Qeriqi, anëtar
13. Argjent Tasholli, anëtar
14. Nazmi Krasniqi, anëtar
15. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
16. Egzona Bytyqi, anëtare
17. Selatin Retkoceri, anëtar
18. Shkelzen Bislimi, anëtar
19. Albulena Kelmendi, anëtare
20. Afrim Miftari, anëtar
21. Hajdin Bytyqi, anëtar
22. Safete Amerllahu, anëtare
23. Bashkim Budakova, anëtar
24. Ukë Kryeziu, anëtar
25. Ganimete Qeriqi, anëtare
26. Manush Shamolli, anëtar
27. Egzona Fazliu, anëtare
28. Arben Salihu, anëtar
29. Fehmi Rexhepi, anëtar

### Të tjerë prezent:

1. Fauz Xhemajli, nënkryetar i Komunës
2. Lulzim Qerimi, nënkryetar i Komunës për komunitete
3. Avni Olluri, drejtor i DA
4. Rasim Hasani, drejtor i DA
5. Latif Ramadani, drejtor i DBF-së

6. Nazim Gashi, drejtor i DMSH,
7. Imer Rustemi, drejtor i DI,
8. Shkelzen Hajdini, drejtor i DEZH
9. Bekim Shabani, drejtor i DRSK
10. Emina Rexhiqi, drejtoreshë e DPU-së
11. Sefer Tasholli, drejtor i DGJK
12. Shefqet Amerllahu, drejtor i DBPZHR
13. Vlora Limani-Hajnuni, drejtoreshë e DSHMS
14. Vlora Krasniqi, zyrtare ligjore
15. Kimete Jashanica, OSBE-së
16. Arben Koshi, OSBE-së
17. Aleksandra Jovanoviq, OSBE-se
18. Bekim Krasniqi, OJQ"YAHR"
19. Bukurije Zejnullahu, zyra e informimit
20. Besart Troshupa, zyra e informimit
21. Përfaqësues të mediave dhe
22. Numër i konsideruar i qytetarëve

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë 28 anëtarët nga gjithsej 31 anëtarë të Kuvendit hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës së propozuar.

### **REND DITE**

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 11-të e Kuvendit
2. Raporti i shpenzimeve dhe te hyrave Janar-Shtator 2018
3. Informatë mbi gjendjen e pronave komunale në ZK. Konjuh që janë dhënë në shfrytëzim afatgjatë
4. Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës
5. Propozim vendim për miratimin e planit orientues të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2019
6. Propozim Vendim për zëvendësimin e anëtares së komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës
7. Propozim vendim për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Komunitete

Daut Azemi, Kryesues i kuvendit pyeti se a ka dikush vërejtje rreth rendit të ditës.

Lulzim Rustemi, tha se vërejtje nuk kam rreth rendit të ditës por pse nuk i keni futur edhe dy pika të rendit të ditës që janë kërkuar për konkursin në arsim dhe pika tjetër informata për ndarjen e kultivatorëve dhe dua sqarim pse nuk janë dalë në rend dite këto dy pika dhe kur do të dalin.

Daut Azemi, Kryesues, tha se te pika e konkursit e kemi marrë me shkrim por ne nuk jemi organ që mund ta shqyrtojmë këtë pikë pasi konkursi ka qenë i hapur dhe publik.

Lulzim Rustemi, tha se unë kam kërkuar vetëm informatë.

Rasim Hasani, tha se punët janë të ndara nga ekzekutivi, konkurset kanë qenë të shpallura në mënyrë publike bazuar në ligjet dhe vendimet e Ministrisë së arsimit.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth rendit, Kryesuesi hodhi në votim dhe pas votimit konstatoi se me 15 vota për, 10 kundër, 4 apstenime u aprovua rendi ditës.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Shkelzen Bislimi, këto ditë është diskutuar ekskursioni i nxënësve pyes pse kompanija nga Podujeva është përzgjedhur? Kisha dashtur me na tregu drejtoria procedurat e tenderimit. Pastaj tha se a do të mund të futen në sistem të pagesës për mbeturina të gjithë banorët e komunës së Lipjanit. Po ashtu dashta të pyes pse në fshatin Gadime një pjesë e ndriqimit punon dhe një pjesë jo.

Argjent Tasholli, tha se ura në rrugën e Shkupit është në rrezik të lartë, a keni qenë ta vizitoni pasi që banorët duhet të punojnë në arat e tyre. Çështjen tjetër e kemi kanalizimin nëpër lagje, te lagja Reçica në fshatin Gllavicë gjatë temperatuave të nxehta është gjendje e rëndë nga gropa skeptike. Po ashtu më ka ardhur një mesazh nga fshati Dobrajë në rrugën për të shkolla është dëmtur rrjeti i kanalizimit aty afër ka banor dhe nxënësit shkojnë në shkollë dhe është rrezik të përhapet ndonjë epidemi. Kjo kërkesë ju ka dërguar edhe asambleistit të LDK-së.

Egzona Bytyqi, para dy jave është mbajtur një tryezë diskutimi nga instituti GAP sa po respektohet marrëveshja e stabilizim asocimit nga qeverisja lokale dhe dashta me ditë sa është fuqizu zyra lokale për integritet evropiane në Lipjan.

Bashkim Budakova, është një kërkesë e fshatit Rubovc me na nda një parcelë për varrezat e fshatit këtë kërkesë e kemi me shkrim të deponuar edhe te Kryetari i Komunës.

Selatin Retkoceri, para disa dite më ka ftuar shkolla e fshatit Lugaxhi pasi jam i zgjedhur Kryetar i këshillit të prindërve dhe jam i njoftuar se ka filluar një reformë nga një shtet evropian Finlanda deshta me ditë sa jemi të përgatitur për një reformë të tillë të sistemit arsimor. Pasi që kjo reformë nuk është kah zbatohet. Deshta me ditë ne si ndërmarrje kaq e madhe Ministria e arsimit, nxënësit, prindërit, shoqëria civile dhe qytetarët. Duke shfletuar këtë kurrikulë pashë se kjo kurrikulë kërkon mësim praktik, kompjuterik, kabinetik etj. Po ashtu dashta me ditë arsimtarët tanë a i kanë këto aftësi për zbatim të kësaj kurrikule pasi janë bartësit kryesor për zbatueshmërinë e reformës evropiane.

Lumturije Bytyqi-Hasani, e dijmë që jenë në fushatë ta pastrojmë ambientin. Kam një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike z. Tasholli se në fshatin Bujan ka dy deponi ilegale ku banorët po shqetësohen për ato deponi që janë afër malit dhe varrezave. Po ashtu edhe për fshatin Shalë është një deponi ilegale dashta me ditë a ka komuna ndonjë marrëveshje me këto kompani sa duhet me qëndru këto mbeturina pasi që ato po qëndrojnë një kohë të gjatë.

Lulzim Rustemi, kemi një peticion i fshatit Bregu i Zi për një deponi që do të realizohet. Juve rregullat ju obligojnë për shqyrtim të këtij peticioni. Ki obligim ligjor për shqyrtim të këtij peticioni.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, Po e kemi marr një peticion nga banoret e Bregut të Zi, I cili ka ardh pas marrjes se vendimit nga Kuvendi. Kemi vlerësuar se ky peticion duhet të pres për shqyrtim sepse kemi pas banorë që janë lajmruar se u janë falcifikuar nenshkrimi prandaj kemi konsideruar që ky peticion mundet të mos jetë real.

Lulzim Rustemi, peticionin e keni obligim të sillni në Kuvend për shqyrtim e për vlefshmërinë vendos Kuvendi e jo ju.

Ramiz Qeriqi, është një kërkesë e qytetarëve të fshatit Krojmir për Lumin pasi që është dimër dhe Lumi është i mbyllur mundësisht me intervenu.

Albulena Kelmendi, qështja e furnizimit me ujë në qytetin e Lipjanit disa kanë dhe disa jo po ashtu edhe nëpër fshatra kemi ankesa që uji vjen vetëm 2 herë në ditë po du me ditë qka ka në plan të bëjë komuna.

Te ndriqimi publik disa rrugë janë ende pa ndiqim publik po ashtu parking prapa komunës nuk ka ndriçim publik.

Çështja e shkollës gjimnazi "Ulpiana" është bërë funksional qe 2 vite, ndërtuesi ka përdorur material jo cilësorë në këtë shkollë është shumë ftoft dhe është bërë shumë e vështirë qështja e proqesit mësimor dashta me ditë a ka në plan komuna për sanimin e këtyre defekteve.

Rasim Hasani, sa i përket pyetjes së Shkelzenit për eskursionin e nxënësve janë organet e shkollës dhe udhëzimi administrative që përcaktojnë procedurat e ekskursionit. Janë kriteret bazë të përcaktuara që i përcaktojnë anëtarët drejtues të shkollës. Në bazë të kriterëve anëtarët e këshillit drejtues dhe në bazë të udhëzimeve administrative është bërë përzgjedhja e firmës për bartjen e nxënësve. Po ashtu në këtë vit kemi pasur çmim më të lirë në hotelet për akomodim dhe kushte shumë më të mira në krahasim me vitet e kaluara. Sa i përket pyetjes se pse nuk kanë fituar firmat e pretenduara, shkollat e kanë pasur pavarësinë e plotë të përzgjedhjes ku anëtari i DKA-së vetëm e ka monitoru procesin. Te reforma të kurrikula e re për t'u bërë kurrikula është dashtë të bëhen disa reforma tjera nëpër shkolla. Vendimet e ministrit janë ato që prodhojnë pasoja për komunën. Pa bërë përgatitje për reformë të re për staf të ri nuk mund të fillohet me kurrikulë të re. Sa i përket kurrikulës në 7 shkolla kemi filluar me kabinete dhe do të vazhdojmë edhe me kabinetet e kimisë. Sa i përket gjimnazit e kemi pasur në gjendje shumë të vështirë dhe këtë punë e ka pasur ministria e arsimit dhe nuk ka ndërmarrë diçka për vitin e ardhshëm e kemi parapa në buxhet.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, kërkoj nga anëtarët e Kuvendit për mos ndërhyrje pa ua dhënë unë fjalën mos ndërhyrje, ngritje dorën unë do të ua jap fjalën.

Illir Tasholli, unë kam dy pyetje qështjen e futjes në sistemin e pagesës për menaxhimin e mbeturinave në komunën tonë. Unë me drejtoreshen Emina Rexhiqi kemi formuar një TASK forcë për eliminimin e deponive ilegale. Sa për informacion prej 1100 ekonomive familjare vetëm 400 prej tyre bëjnë pagesë. E kemi një marrëveshje me kompanin regjionale "Pastrimi" me i sjellë afër 3000 kontinjerë për mbeturina dhe duke i shpërndarë kontinjerët të njëjtën kohë duke i nënshkruar kontratat me një shumë prej 4.70cent që po mendojmë. Sa i përket shërbimeve për mbeturina afër 45% të territorit është e përfshirë. Sa i përket kanalizimit të lagja Reçica qytetarët na kanë lajmëruar jemi në kontakte të vazhdueshme, kemi rritur rrjetin e kanalizimeve kemi me fillu edhe me sanimin e dëmeve edhe në fshatin Dobrajë dhe në gjitha vendet ku ka nevojë. Sa i përket urës për Shkup kemi intervenu disa herë policia i ka vendosur shiritat i kanë larguar na e dijmë se aty kemi edhe një rrugë alternative që mundën me kalu. Sa i përket pyetjes së Ramizit për Lumin e fshatit Krojmir besoj se kompania në këto moment është duke e kryer punën. Sa i përket ndriqimit kemi një lajm të mirë, tash kemi një kompani që do të merret me këtë punë. Sa i përket ndriqimit në fshatin Gadime, në Babush, te rruga e Kishes dhe në tërë komunën e Lipjanit do të kemi ndriqim.

Shkelzen Hajdini, sa i përket pyetjes rreth zyrës për integritet evropian, zyria është funksionale, punon dhe vazhdon të monitoroj punën e ekzekutivit dhe të raportoj në MAPL në bazë ditore periodike.

## I

### **Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 11-të e Kuvendit**

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë.

Arben Salihu, në faqen 17 duhet të përmirësohet në vendë të fjalës po ashtu të shkruhet pastaj.

Meqë vërejtje të tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 11-te dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 votat për, 1 apstenim

## **Aprovoi**

### **Ekstraktin nga mbledhja e 11-të e Kuvendit**

**Shtesë:** Ekstrakti.

## II

### Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Shtator 2018

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën Latif Ramadanit, drejtor i DBF-se, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Shtator 2018.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rustemi, te shpenzimet buxhetore pse ky shpenzim aq i vogël në krahasim me periudhën që është kalu. Donacionet e bartura pse janë zero, buxheti dhe shpenzimet sipas kategorive ekonomike paga dhe medijtë shfrytëzohen mirë dhe kërkoj sqarim pse një rritje kaq e madhe të pagave. Te shpenzimet e granteve qeveritare pasi jemi në muajt e fundit. Te buxheti të hyrat vetanake po ashtu jemi në fund kemi pak të hyra. Bujqësi Zhvillim Rural kemi shpenzime shumë të vogla. Te arsimit parafillor grantet qeveritare, shpenzimet janë zero. Krahasimi i buxhetit në bazë të planifikimeve mallra dhe shërbime dhe kategorit tjera shpenzimet dalin më të vogla se vitin e kaluar. Sa i përket shpenzimeve të mëdha kemi për telefona mobil. Furnizim për zyre shpenzimet e mëdha. Po ashtu për karburante dhe drekat zyrtare kemi shpenzime të mëdha dhe për këto shpenzime kërkojmë sqarim.

Selatin Retkoceri, tha se sa i përket shpenzimit të buxhetit për paga nuk është ajo shumë është një gabim që e ka bërë OJQ"Polis". Rritja e shpenzimeve për paga është 2.8% e jo 20%, është mirë me ditë se cilat shpenzim duhet me pasur rritje e cilat jo. Unë edhe herave të kaluara i kam kushtuar rëndësi qështjes së arsimit, shëndetësisë edhe zhvillimit ekonomik. Sa i përket zhvillimit ekonomik e dijmë që papunësia shumë e madhe, shpenzimet janë të vogla dhe ne kemi nevojë për investitorë të jashtëm dhe të brendshëm të mbajmë takime, tryeza etj. Sa i përket drekave zyrtare mu po më duket se pak janë shpenzuar.

Ju kisha bërë thirrje për buxhetin është mirë me marrë pjes dhe me pasur një interesim më të madh.

Albulena Kelmendi, vërejmë se raporti i shpenzimeve nga viti në vit është i njejt. Po ashtu vërejmë se shpenzimet kapitale janë të vogla të buxhetit, koha është e shkurtur edhe 2 muaj dhe nuk do të shpenzohet dhe qka bëhet me këto mjete financiare. Në disa projekte të natyrës së njejtë e shpenzimeve është i njëjtë me atë të planifikuar. Sa i përket shpenzimeve tjera për dreka e darka kemi shpenzime të mëdha.

Ukë Kryeziu, sa i përket shpenzimit të buxhetit në këtë buxhet janë të involvuar të gjithë drejtorët dhe mekanizmi i komunës, për një shpenzim të drejtë. Ky raport besoj se është real dhe nuk po dyshoj aspak.

Pajtohem me atë qka e tha Luli, por unë kam një shqetësim te grupi parlamentar të AAK-së, ku në disa pika ku shpenzohet buxheti dhe ku ka nevojë. Por len shumë për të deshiru për disa projeksione buxhetore. Te investimet kapitale pyes drejtorin si është e mundur vetëm 2 milion me u investu. Te shpanzimet e buxhetit për nëntë muaj të këtij viti kemi më shumë se në vitin 2017. Është mirë të shpenzohen mjete buxhetore në mirëmbjtje të projekteve. Në shëndetësi nuk është puna edhe aq mirë ëshë mungesa e barnave esenciale. Është mirë që të investohet në disa objekte shkollore aty ku është investu, sikur te ne në Sllovi që jemi në përfundim të ndërtimit të shkollës të ketë investime edhe në shkollat tjera.

Latif Ramadani,raporti i zyrës kryetarit është raport që delë nga drejtorati për buxhet dhe financa dhe nuk mund të ketë rritje të pagave 20%. Ndërsa sa i përket shpenzimeve nga zyrët e drejtorëve secili drejtor i ka nga 20 euro vlerë.

Ramiz Qeriqi, te ekipet e sportit te KF"Ulpiana" 1996 e kanë një borxh te restorant Golen Dey, është mirë me ia nda do pare me ia paguar borxhin.

Latif Ramadani, ne nuk kemi të drejtë me ju përzi ekipeve se ku hyjnë borxh dhe nuk mundemi me ju paguar borxhet.

Lumturije-Bytyq-Hasani, për furnizimet e mjekësisë nuk na dhatë përgjigjje duam një sqarim për këtë.

Nazmi Krasniqi, për mua është e rëndësishme cilësia e punëve që do të bëhen, jo të shtrohen rrugë të ngushta siqë është rasti në Kleçkë ku nuk mund të kalojnë 2 vetura.

Argjend Tasholli, unë dua të flas për reagimin e bërë ku gabimi nuk është vetëm i yni por edhe i juaji. Mua raporti më ka ardhur me datën 22 dhe unë e kam bërë reagimin me datën 22 në bazë të raportit të Polisit, ndërsa raporti shtesë më ka ardhur me datën 24. Ndërsa sa i përket reagimit të komunës ka qenë jo serioz është dashtë të reagoj me faktura.

Lulzim Rustemi, ne po flasim për raportin nëntë mujor dhe sa i përket këtij raporti shihet se shpenzimi është shumë i vogël por presim çka do të ndodh deri në fund të vitit.

Latif Ramadani, sa i përket shpenzimeve për telefoni fikëse ato janë të bartura nga vitet 2016 dhe 2017 këto të dhëna po i jepim nga raporti zyrtar.

Vlora Limani, sa i përket shpenzimeve të drejtoratit për shëndetësi huamarrje janë 138 mijë euro dhe nuk kemi mundur me i harxhu pasi që nuk janë caktuar se për çka do të shfrytëzohen dhe këto nuk mundemi me i shfrytëzu se nuk janë aloku.

Ukë Kryeziu, pas sqarimit nga drejtoresha është mirë që me insistu që këto mjete me i shfrytëzu për barna esenciale. Është një huamarrje e padrejtë që është bërë nga SISH-i.

Megjë diskutime tjera nuk pati u kalu në pikën tjetër të rendit të ditës.

Kryesuesi dha pauzë në ora 12,<sup>10</sup>

### III

#### **Informatë mbi gjendjen e pronave komunale në ZK. Konjuh që janë dhënë në shfrytëzim afatgjatë**

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën Sefer Tashollit, drejtor i DGJK-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Informata.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Shkelzen Bislimi, tha se kjo informatë nxjerrë në sipërfaqe qasjen e gabuar dhe si e tillë është e mangët. Kjo informatë shihet se disa prej pronave nuk janë shfrytëzuar dhe nuk është bërë asnjë investim, ndërsa ka të tilla që janë dhënë në shfrytëzim në vitin 2007-2008-2009 dhe kanë filluar të ndërtohen tash në vitin 2018. Ne nuk duhet të lejojmë që pronat komunale të mbesin të bllokuara për 99 vite. Ndërsa në disa prona edhe pse janë shkëputur kontratat prona nuk është kthyer në gjendjen e mëparshme. Komuna duhet t'i shikoj këto kontrata se a janë bërë investimet konform këtyre kontratave. Nga të gjitha këto prona shihet se vetëm 6 prej tyre kanë filluar ndërtimin.

Selatin Retkoceri, qëllimi i kësaj ka qenë i mirë por kemi dështuar në start. Kemi shpresu që ka me dalë diçka shumë e mirë për Lipjanin por dulë krejtë ndryshe. Konkursi kur është hapura është dashtë me qenë ndërkombëtar. Gjithsej janë 27 hektarë, për mua më mirë ata të cilët nuk kanë filluar fare të ndërtojnë se sa ata që kanë ndërtuar dhe nuk kanë bërë asgjë. Aty është marrë kinse do të ndërtohet një fabrikë dhe nuk është bërë asgjë nga Albi pasi që janë shitur filterat e qajit dhe janë punësuar 4-5 persona. Mos të ish kanë UBT-ja aty do të ishte një gjendje e mjerueshme. Ku në 35% të pronave ka diçka, ndërsa 65% prej tyre nuk është bërë asgjë.

Lulzim Rustemi, kemi një informatë për 27 hektar një koncept në dështim e sipër, ky raport është i mangët ku në fillim kjo ka dështuar pasi që nuk janë përcjellur projektet. Ky raport është i mangët edhe për disa gjëra pasi që vetëm disa kanë punuar, ndërsa të tjerët nuk ju kanë përmbajtur kontratës, ku prej tyre vetëm UBT ju ka përmbajtur kontratës ndërsa të tjerat jo. Komuna duhet të bëjë një strategji rreth këtyre pronave, duhet me ju marrë ato prona pasi që aty nuk ka shpresë se do të bëhet diçka.

Hyra Bytyçi, është një informatë mjaftë e rëndësishme dhe ne i falenderojmë për këtë informatë. Këtu kemi edhe projekte të cilave ju kanë shkëputur kontratat, dhe në sqarimin që na i dha drejtori shihet se në kontrata do të ketë kritere ku nuk mund të keqpërdoret prona.

Ukë Kryeziu, sa i përket informatës unë kisha për t'i ngritur disa qështje, kontratat janë dhënë në bazë të ligjeve dhe Rregulloreve të kohës, çështja tjetër kemi kontrata që deri

dikun kanë arritur në investimin e tyre, por kemi edhe kontrata që nuk kanë levizur fare. Ndërsa çështja tjetër duhet t'ua shkëpusim kontratat njëherë e përgjithmonë atyre që nuk ju kanë përmbajtë kushteve të kontratës.

Ramiz Qeriqi, është një informatë e mangët, së paku është dashtë me pasur një kontratë të fotokopjune pasi që me sa e dijë unë ata kanë qenë të obliguar me i marrë punëtorët nga Lipjani. Komuna ka qenë e obliguar me i siguru infrastrukturën. Na po e kretikojna vetëm “Benafin” të paktën ai bile ka ndërtuar diçka, ndërsa “Standard Benzi” le që ska ndërtu por edhe e ka shti pronën në hipotekë. Pse na mos me ja bo një padi këtyre që i kanë keqpërdorë.

Nazmi Krasniqi, kemi një raport të shkurtër që nuk ka diçka të veçant, të gjitha këto biznese kanë pasur për qëllim zhvillimin ekonomik por nuk kanë bërë asgjë. Ky është një projekt i dështuar dhe kam një pyetje për drejtorin sa punëtorë të komunës së Lipjanit janë pranuar këtu?

Albulena Kelmendi, pajtohem me shumicën që e thanë, me sa u tha dje në KPF afati ligjor për me i mbushur kontratat këto kompani ka qenë 3 vite. Me sa e dijë unë nga 2006-2009 po bëhet 3 vite, tash jemi në vitin 2018 që ju kanë dhënë këto prona, ky projekt që ka mundur me qenë zhvillimor po del i dështuar. Unë këtu po e shoh se disave i kanë përmbush apo nuk i kanë përmbushur kriteret ju kanë shkëputur kontratat e disave jo. Jam për me u ngrit procese gjyqësore për të gjithë ata që e kanë keqpërdorë pronën e shtetit.

Afrim Miftari, e falenderojmë drejtorin për këtë informatë dhe kërkojmë ta dijmë a ekziston secila kontratë. Është mirë që ne me trajtuar secilën kontratë veç e veç dhe në fund me marrë një vendim që nuk është i dëmshëm për komunën e Lipjanit.

Selatin Retkoceri, ne nuk duhet të merremi me ata sepse ato janë palë, por ne duhet me u marrë me defektet tona. Ne e dijmë se në fillim ka pasur projekte ideore por e dijmë që Benafi ka falimentu po ashtu edhe “Standard Benzi” është në të njejtën rrugë. Por unë ndi keqëardhje se ne si Lipjan kemi dështu po edhe si Kosovë.

Arben Salihu, ne e dijmë se edhe Komuna që e ka dhënë këtë pronë në shfrytëzim por edhe pronarët kanë pasur një qëllim të mirë, ne nuk duhet të merremi me ate se çka ka ndodhur por është mirë të formohet një komision nga ekspertet dhe të shohim se çka mund të bëjmë në të ardhmen.

Nazmi Krasniqi, unë nuk pajtohem me Selatinin me fjalët çka i tha, pasi që dihet mirë Kosova ku ka qenë dhe tani ku është.

Selatin Retkoceri, unë asnjëherë nuk kam qenë në ekzekutiv.

Sefer Tasholli, ju falenderoj për interesimin, kjo ka qenë vetëm një informatë e jo raport dhe ne jemi munduar me ju spjeguar për secilën pronë kush e ka marrë, sa e ka shfrytëzu etj. Nuk kanë pasur obligim ligjor me naj marr punëtorë nga Lipjani por ne mund të marrim ndonjë informatë se sa punëtorë janë të punësuar. Ne i kemi marrë 5 prona mirëpo 2 prej tyre kanë bërë ankesë. Çdo pronë e ka kontratën dhe unë i kam disa me veti.

Nazmi Krasniqi, unë e pyeta drejtorin se sa punëtorë janë punësuar në ato kompani.

Ramiz Qeriqi, është mirë të gjithë me u marrë me këtë qështje, ku unë e falenderoj UBT-në që ka bërë 50% zbritje për studentat e komunës së Lipjanit.

Albulena Kelmendi, ju duhet me qenë të lumtur që na po bëjna pyetje rreth kësaj qështje pasi që jemi të interesuar për të mirën e qytetarëve.

Ukë Kryeziu, e falenderoj drejtorin që dha një sçarim shumë të saktë.

Lulzim Rustemi, është një informatë për ne, por ne duhet të shohim se çka do të veprojmë më tutje për këto prona, që të ipen në shfrytëzim për të mirën e qytetarëve.

Sefer Tasholli, nuk gjeta asnjë nen në kontratë që thuhet që duhet t'i punësoj punëtorët e Lipjanit.

Megë diskutime tjera nuk pati u kalu në pikën tjetër të rendit të ditës.

## **Propozim Vendim paraparak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës**

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën Shkelzen Hajdinit, drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Megjithatë diskutime nuk pati rreth kësaj pike, Kryesuesi hodhi në votim dhe pas votimit konstatoi Kuvendim me 26 vota për, aprovoi këtë:

### **VENDIM PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS**

#### **Neni 1**

Me këtë Vendim ipen në shfrytëzim afatshkurtër subjekteve politike që kanë të themeluar degët e tyre në Komunën e Lipjanit, paluajtshmëritë-lokalet në pronësi të komunës të shënuara më poshtë, të cilat gjenden në parcelën kadastrale: P-71409044-01773-1 Zona kadastrale në Lipjan për zhvillimin e aktiviteteve të tyre politike.

| Nr. | Njësia kadastrale                                          | Adresa                   | Kati      | Sipërfaqe<br>m <sup>2</sup>                  | Gjithsej<br>m <sup>2</sup> |
|-----|------------------------------------------------------------|--------------------------|-----------|----------------------------------------------|----------------------------|
| 1   | O-71409044-01773-1-11-3-10<br>O-71409044-01773-1-11-3-11-0 | Rr.Sheshi "Adem Jashari" | P+4<br>-- | 34.47 m <sup>2</sup><br>31.48 m <sup>2</sup> | 65.95<br>m <sup>2</sup>    |
| 2   | O-71409044-01773-1-11-3-12-0                               | Rr.Sheshi "Adem Jashari" | P+4       | 40.59 m <sup>2</sup>                         |                            |

#### **Neni 2**

Sipas nenit 1 të këtij Vendimi pronat-lokalet me Nr. rendor 1 (sipërfaqe prej 65.95 m<sup>2</sup>) dhe me Nr. rendor 2 (sipërfaqe prej 40.59 m<sup>2</sup>) ipen në shfrytëzim, afatshkurtër në afat prej 10 vitesh nëpërmjet ankandit publik të përcaktuar sipas Rregullores QRK Nr.23/2013 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

#### **Neni 3**

Dhënia e lokaleve në shfrytëzim sipas këtij vendimi bëhet me qëllim të realizimit të interesit publik dhe rritjes së vlerës së pronës publike komunale me destinim për subjektet politike-që kanë të themeluara degët e tyre në Komunën e Lipjanit për zhvillimin e aktiviteteve të tyre politike.

#### **Neni 4**

Procedurën e ankandit publik e zbaton Komisioni Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal 15Nr.463-67906 të datës 22.12.2017, në bazë të Rregullores QRK Nr.23/2013 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

#### **Neni 5**

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-sektori pronësoro-juridik, Drejtorati për Ekonomi e Zhvillim dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

#### **Neni 6**

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

## **Neni 7**

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi fshihet pjesërisht paragrafi 1.6 lokali me sipërfaqe prej 54 m<sup>2</sup> i pikës 1 të Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës së Lipjanit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste të Komunës 15Nr.464-45591 të datës 12.11.2014.

Shtesë: Vendimi.

## **V**

### **Propozim vendim për miratimin e planit orientues të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2019**

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën Emina Rexhiqit , drejtoreshë e DPU, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 votat për, aprovoi këtë:

## **VENDIM**

### **PËR MIRATIMIN E PLANIT ORIENTUES TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT PËR VITIN 2019**

#### **Neni 1**

MIRATOHET Plani orientues i punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2019.

#### **Neni 2**

Kuvendi i Komunës së Lipjanit planifikon t'i mbajë 12 mbledhje të rregullta dhe secilës mbledhje të rregullt i paraprin mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

#### **Neni 3**

Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës do të mbahen sipas periodës kohore me rendin e ditës sipas tabelës në vijim:

|               |                                                                                                                         |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| JANAR 2019    | <u>Informatë e Kryetarit mbi Planin e Punës së Ekzekutivit për vitin 2019</u>                                           |
|               | <u>Raporti i Kryetarit mbi gjendjen ekonomike financiare të Komunës për periudhën Korrik Dhjetor 2018</u>               |
|               | <u>Miratimi i Planit Vjetor të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)</u>                             |
|               | <u>Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal</u>                                             |
| SHKURT 2019   | <u>Bartja (rialokimi) i buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual</u>                                  |
|               | <u>Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal</u>                                             |
|               | <u>Shqyrtimi i raportit monitorues për zbatimin e qëllimeve dhe objektivave nga PZHK, PU dhe PRR për vitin paraprak</u> |
|               | <u>Informatë mbi përfundimin e gjysmëvjetorit të parë shkollor</u>                                                      |
| MARS 2019     | <u>Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal</u>                                             |
|               | <u>Shqyrtimi i Raportit final financiar të Komunës për vitin 2018</u>                                                   |
| PRILL 2019    | <u>Shqyrtimi i informatës tremujore financiare të Komunës për periudhën Janar – Mars 2019</u>                           |
|               | <u>Informatë mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre</u>                                                    |
|               | <u>Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal</u>                                             |
| Maj 2019      | <u>Informatë mbi Qarkoren e parë buxhetore të MF-se</u>                                                                 |
|               | <u>Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal</u>                                             |
|               | <u>Informatë mbi punën e komiteteve funksionale</u>                                                                     |
| QERSHOR 2019  | <u>Miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2020-2022</u>                                                                |
|               | <u>Rishikimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2019</u>                                                                   |
|               | <u>Shqyrtimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSB-së</u>                                                  |
|               | <u>Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal</u>                                             |
|               | <u>Informatë mbi realizimin e Planit të Prokurimit</u>                                                                  |
| KORRIK 2019   | <u>Shqyrtimi i informatës financiare të Komunës për periudhën Mars – Qershor 2019</u>                                   |
|               | <u>Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për Komunën për vitin 2018</u>                                     |
|               | <u>Informatë mbi Raportin e Performancës</u>                                                                            |
|               | <u>Informatë mbi përfundimin e vitit shkollor</u>                                                                       |
|               | <u>Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal</u>                                             |
| GUSHT 2019    | <u>Informatë mbi përfundimin e fushatës së korrje-shirjeve</u>                                                          |
|               | <u>Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal</u>                                              |
|               | <u>Informatë mbi Qarkoren e dytë buxhetore të MF-se</u>                                                                 |
| SHTAT OR 2019 | <u>Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2020</u>                                                      |
|               | <u>Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2020</u>                                   |
|               | <u>Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor</u>                                                                    |

|                       |  |                                                                                                                     |
|-----------------------|--|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                       |  | <u>Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal</u>                                         |
|                       |  | <u>Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për tatimin në pronë</u>                                                    |
|                       |  | <u>Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për taksa komunale</u>                                                      |
| <b>TETOR</b><br>2019  |  | <u>Shqyrtimi i raportit financiar të Komunës për periudhën Korrik – Shtator 2019</u>                                |
|                       |  | <u>Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal</u>                                         |
| <b>NËNTOR</b><br>2019 |  | <u>Informatë e Drejtoratit për Shëndetësi dhe përkujdesje sociale për ofrimin e shërbimeve primare shëndetësore</u> |
|                       |  | <u>Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal</u>                                         |
|                       |  | <u>Informatë e Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural mbi të mbjellurat</u>                           |
| <b>DHJETOR 2019</b>   |  | <u>Informatë mbi Planin Vjetor të Prokurimit Publik 2020</u>                                                        |
|                       |  | <u>Shqyrtimi i propozim-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal</u>                                          |
|                       |  | <u>Informatë mbi Planin Vjetor të Auditorit të Brendshëm 2020</u>                                                   |
|                       |  | <u>Shqyrtimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKS-së</u>                                               |
|                       |  | <u>Informatë nga Drejtoria për Rini, Kulturë dhe Sport</u>                                                          |
|                       |  | <u>Informatë mbi funksionimin e këshillave lokale</u>                                                               |

#### **Neni 4**

4.1 Kuvendi i Komunës, për shqyrtimin e çështjeve nga kompetenca e vet, të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, dispozitave tjera ligjore, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit mban së paku dhjetë mbledhje të rregullta brenda vitit kalendarik.

4.2 Kuvendi i Komunës mund të mbajë edhe më shumë mbledhje të rregullta brenda vitit kalendarik.

4.3 Kuvendi i Komunës mund të mbajë edhe mbledhje të jashtëzakonshme, urgjente dhe solemne në rastet e caktuara me dispozitat e cekura ligjore.

#### **Neni 5**

Plani i mbledhjeve të Kuvendit, i përcaktuar si në nenin 3 të këtij Vendimi është orientues dhe do të mund të ketë ndryshime gjatë vitit.

#### **Neni 6**

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës

### **VI**

#### **Propozim Vendim për zëvendësimin e anëtares së komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Anila Reçica-Llugiqi, propozoi Majlinda Sylejmanin, për anëtare të komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

Megjë diskutime rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 votat për, 1 apstenim, aprovoi këtë:

**VENDIM**  
**PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARES SË KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN NË**  
**SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS**

**Neni 1**

Me këtë Vendim **zëvendësohet** anëtarja e Komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Linda Shahini nga subjekti politik LDK, e emëruar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit 15Nr.463-67906 të datës 22.12.2017, në numrin rendor 4 dhe në vend të saj caktohet Majlinda Sylejmani nga i njëjti subjekt politik LDK, i përfaqësuar në Kuvendin e Komunës për shkak se e lartëcekura ka kaluar në një detyrë të re të punës në kuadër të Shërbimit Civil.

**Neni 2**

Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati i anëtarëve të komisionit është i përcaktuar me dispozitat e Vendimit të Kuvendit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit 15Nr.463-67906 të datës 22.12.2017

**Neni 3**

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në WebFaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

**VII**

**Propozim vendim për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Komunitete**

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Selatin Retkoceri, mandoj se të shkohet me votim të hapur dhe mendimi im është që të zgjidhet qyky 67 i lindur.

Albulena Kelmendi, pasi që nuk kanë sjellë një CIVI me standarde evropiane, vota ime është kundër.

Arben Salihu, meqë janë dy anëtarë të Komunitetit që nuk po e njohim asnjërin propozoj që të shkohet me votim të fsheht.

Afrim Miftari, kërkoj që të bëhet zgjedhje e këtij anëtar me votim të fsheht.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim procedurën e votimit me votim të fsheht me të gjitha votat e anëtarëve prezent Kuvendi , aprovoi këtë:

Kryesuesi ftoj anëtarët të propozojnë nga një anëtarë për komision.

Anëtarë të komisionit u zgjodhën:

1. Anila Reçica-Llugiqi
2. Lumturije Bytyqi-Hasani
3. Hajdin Bytyqi

Fillon procedura e votimit Kryesuesi fton anëtarët një nga një për votim.

Pas përfundimit të votimit Kryesuesja e Komisionit Lumturije Bytyqi-Hasani, ku i njoftoi se gjithsej kan votuar 29 ku me 16 vota për zgjidhet Sllavisa Trajkoviq, ndërsa për kandidatin Ivica Miriq, 2 vota, dhe 11 vota të pa vlefshme.

**V E N D I M**  
**PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARIT TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE**

**Neni 1**

**Zëvendësimi i anëtarit të Komitetit për Komunitete**

Me këtë Vendim, zëvendësohet anëtari i komitetit për komunitete z. Boban Jovanović i caktuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës për themelimin e Komitetit për Komunitete 15Nr.020-67918 të datës 22.12.2017, në numrin rendor 8 dhe në vend të tij CAKTOHET Slavisha Trajković nga Lipjani, për arsye të dorëheqjes së z. Boban Jovanović për arsyet e tij personale të cekura në aktin e tij mbi dorëheqjen.

**Neni 2**

**Detyrat, përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi**

Detyrat , përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi i anëtarëve të Komitetit për Komunitete janë të përcaktuara me dispozitat e neneve 51 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 33 dhe 35 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Udhëzimit administrativ nr.03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komuniteteve të përherëshme në Komunë si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës për themelimin e Komitetit për Komunitete 15Nr.020-67918 të datës 22.12.2017.

**Neni 3**

**Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas e publikimit në WebFaqen e Komunës.

**Shtesë:** Vendimi.

Pasi që çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15,<sup>50</sup>

**Ekstraktin e hartoi**  
**Rrahim Krasniqi**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Daut Azemi**